

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6591
E shtunë, 23 prill 2022
çmimi 0.40 €

Klinika Infektive nuk ka pacientë të konfirmuar me Covid



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

QEVERIA NUK PËRKRAH EDHE NJË TËRHEQJE TË MJETEVE NGA TRUSTI

TËRHEQJA E 30-PËRQINDËSHIT TË TRUSTIT, NË DORËN E DEPUTETËVE



Qeveria e Kosovës ka njoftuar se nuk e përkrah nismën e Kuvendit të Kosovës për tërheqjen e 30 për qind të mjeteve nga Trusti. "Tërheqja e mjeteve nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë, pasi që vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët", ka njoftuar qeveria. Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, i cili e ka iniciuar këtë nismë për tërheqjen e mjeteve nga Trusti, ka theksuar se tashmë kjo mbetet në duart e deputetëve. Ai beson se deputetët do të votojnë me integritet për kërkesën e qytetarëve për t'ua mundësuar atyre tërheqjen e mjeteve nga Trusti

FEJTON

PARIMET MBI TË CILAT KANË VEPRUAR LUFTËTARËT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE



KONVENTA E LDK-SË MBAHET MË 29 DHE 30 PRILL

ME RASTIN E DITËS SË TOKËS MBAHEN AKTIVITETE PËR EDUKIMIN MJEDISOR

EKONOMI



KOSOVA PËRFITON 51 MILIONË EURO NGA BANKA BOTËRORE

GUVERNATORI MEHMETI TAKO DREJTUESIT E LARTË TË FMN-SË DHE TË BB-SË

SPORT

KOK-U MBULON SHPENZIMET E OPERIMIT TË NORA GJAKOVËS

Presidenti i Letonisë: E mbështesim Kosovën në BE dhe NATO

FAQE 5



PDK-ja DORËZON KALLËZIM PENAL NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË ZRRE-SË

FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja: Vazhdon regjimi i letrave ngjitëse për targat

BRUKSEL, 22 PRILL - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian për Çështje të Jashtme dhe Siguri, Peter Stano, ka thënë se BE-ja shpreh keqardhje për mosarritjen e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për targat në takimet e fundit në kuadër të dialogut porse, në mungesë të marrëveshjes për një zgjidhje afatgjatë, do të vazhdojë të vlejë regjimi i letrave ngjitëse. “Të mërkurën grupet punuese për targat e automjeteve përfunduan punën e tyre për kërkimin e një zgjidhjeje të përhershme për çështjen e targave, bazuar në standardet dhe praktikën e BE-së. BE-ja shpreh keqardhje pse nuk u arrit marrëveshja dhe për çështjen e targave ndërmjet dy kryenegociatorëve. Pasi nuk ka një marrëveshje për zgjidhje të përhershme, regjimi i letrave ngjitëse do të vazhdojë të jetë në fuqi”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Stano.

Ai ka deklaruar se Bashkimi Evropian, në cilësinë e lehtësuesit të dialogut, fton kryenegociatorët e Kosovës dhe të Serbisë të takohen përsëri në ditët në vijim në Bruksel që të pajtohen për rrugën përpara dhe të gjejnë një zgjidhje. “BE-ja dhe



bashkësia ndërkombëtare pret nga të dyja palët që të përmbahen nga çfarëdo veprimi i njëanshëm, i cili do të mund ta rrezikonte sigurinë në terren dhe do ta komplikonte edhe më

shumë përparimin në dialog”, ka thënë Stano.

Duke iu referuar takimit të fundit të kryenegociatorëve, që u zhvillua të enjten në Bruksel, Stano ka thënë se në atë takim u

diskutuan edhe çështje të tjera aktuale, përfshirë edhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura më parë në dialog, si dhe përgatitjen e terrenit për takimin e ardhshëm në nivel të lartë.

“Diskutimet për këto çështje do të vazhdojnë në ditët në vijim”, ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Edhe kryenegociatori i Serbisë, Petar Petković, ka thënë se marrëveshja për përdorimin e letrave ngjitëse është në fuqi dhe, sipas interpretimit të tij, ajo nuk ka skaduar e do të vlejë derisa të mos arrihet ndonjë marrëveshje tjetër.

Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, pas takimit në Bruksel të enjten, kishte thënë se Kosova do t'i qaset çështjes së lirisë së lëvizjes në të njëjtën mënyrë si Serbia. Ai kishte thënë se Kosova nuk do të bëjë veprime të menjëhershme. Në BE vazhdojnë të kërkojnë nga palët që të tregojnë përmbajtje në mënyrë që të mos shihet përsëritja e tensioneve që kishin ndodhur në shtator të vitit të shkuar kur Kosova kishte nisur ta zbatojë reciprocitetin, ndërsa serbët në veri të Kosovës kishin bllokuar rrugët. Atëherë u arrit pajtim për një zgjidhje kalimtare, ndërsa mandati prej gjashtë muajsh iu dha grupeve punuese që të gjejnë një zgjidhje të përhershme. Ky afat ka skaduar të enjten dhe pajtimi për zgjidhje nuk është arritur në këtë afat.

Zelensky: Ukrainës i duhen 7 miliardë dollarë në muaj për t'i rikuperuar humbjet ekonomike



KIEV, 22 PRILL - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Ukrainës i duhen 7 miliardë dollarë në muaj për t'i rikuperuar humbjet ekonomike të shkaktuara nga pushtimi rus. Zelensky, gjatë adresimit në një forum të Bankës Botërore, tha se komuniteti ndërkombëtar duhet ta largojë menjëherë Rusinë nga institucionet ndërkombëtare financiare.

Ai, po ashtu, u bëri thirrje të gjitha shteteve që t'i prishin raportet me Moskën.

Shtetet perëndimore veçse kanë vendosur një sërë kufizimesh ndaj sektorëve financiarë të Rusisë dhe sanksione të tjera ndaj

ekonomisë ruse.

Presidenti ukrainas, po ashtu, tha se bllokada ruse në portet e Detit të Zi ka bllokuar eksportet ukrainase, duke ndikuar në sigurinë e ushqimit në botë.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Së fundmi ajo është fokusuar në lindje dhe jug të Ukrainës, përgjatë bregdetit të Detit të Zi. Ukraina është një prodhuese dhe eksportuese kryesore globale e drithërave dhe pothuajse të gjitha eksportet e saj janë transportuar tradicionalisht nga portet e saj të Detit të Zi. Para luftës, eksportet mujore të drithërave i kalonin 5 milionë tonë.

Johnson: Javën e ardhshme do ta rihapim ambasadën në Kiev

LONDËR, 22 PRILL - Kryeministri britanik Boris Johnson ka thënë se Mbretëria e Bashkuar do ta rihapë ambasadën e saj në Kiev javën e ardhshme, pasi misioni diplomatik është zhvendosur në Lviv disa ditë pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës.

Duke folur më 22 prill gjatë vizitës në Indi, Johnsoni tha se “në javën e ardhshme do ta

rihapim ambasadën tonë në kryeqytetin ukrainas”. Megjithatë, ai nuk tregoi datën e saktë se kur do të ndodhë një gjë e tillë.

Ndërkaq, sekretarja e Jashtme, Liz Truss, përmes një deklarate për medie, tha se rihapja e ambasadës do të ndodhë për shkak të “qëndresës që jashtëzakonshme dhe suksesit” të rezistencës së

Ukrainës ndaj forcave ruse. “Dua ta përgëzoj ekipin e ambasadës për trimërinë dhe për punën gjatë kësaj periudhe”, tha Truss.

Më herët, po gjatë këtij muaji, kryeministri britanik Boris Johnson kishte vizituar Kievin për ta shprehur mbështetjen për Ukrainën, shtet që prej 24 shkurtit po përballë me pushtimin rus.



“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës? (4)

Parimet mbi të cilat kanë vepruar luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



Shkruan: Kudusi LAMA

Dhe sa për t'i njohur kjo prokurori naziste dhe kjo gjykatë zvarritëse, po ju citoj parimet mbi të cilat janë mbështetur, janë urdhëruar të vepronë dhe kanë vepruar luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës:

1. Asnjë luftëtar nuk ka të drejtë të dëmtojë sllavët që janë banorë të hershëm në territoret tona, përveç atyre që qëndrojnë me armë në dorë kundër qëllimit shqiptar për liri e pavarësi;

2. Asnjë luftëtar nuk ka të drejtë të djegë shtëpitë, rrënojë kishat serbe;

3. Ndalohet rreptësisht grumbullimi i plaçkës së luftës nga luftëtarët. Plaçka nuk është pjesë e luftës;

4. Asnjë luftëtar nuk ka të drejtë të shëmtojë trupat e të vranëve të armikut, as t'i zhveshë armiqtë e vranë, të plagosur ose të zënë robër;

5. Veprimtaria luftarake të jetë e gjallë dhe intensive vetëm kundër ushtrisë, mercenarëve dhe paramilitarëve, edhe në qoftë se armiku bën mizori ndaj shqiptarëve pa armë, për asnjë arsye nuk duhet të vepronet jashtë këtij standardi;

6. Sllavët si banorë të hershëm në territoret shqiptare, të cilët me kohë janë vendosur dhe kanë jetuar së bashku me shqiptarët, si dhe mjedisi të ruhen me forca;

7. Kot e pa nevojë as gjaku i popullit tonë, as gjaku i popullit të armikut s'duhet të derdhet. Por, aty ku është nevoja, asnjë luftëtar të mos guxojë të kursejë aspak gjakun e vet e të të vetëve;

8. Të huajt që vijnë në territoret ku luftohet për të parë veprimet luftarake e për t'u njohur me situatën, qofshin evropianë apo amerikanë, diplomatë, politikanë apo gazetarë etj., të ruhen me njerëzit më besnikë dhe më të komunikueshëm;

9. Të vranët shqiptarë nga popullata e masakruar të mos varrosen deri sa të vijë komisioni i huaj, nga OSBE-ja, ose, nga organizma të tjerë ndërkombëtarë. Mizoritë e bëra prej armikut, të evidentohen dhe të shënohen saktë për t'ua treguar Evropës dhe Amerikës;

10. Na takon e drejta për të luftuar deri në vetëmohim për të arritur që të jemi të barabartë me të gjithë popujt e tjerë, ta bëjmë luftën e fitojmë lirinë;

11. Kosova është mbjellë me kockat e armiqve të ardhur nga ana e anës për ta pushtuar, aq sa mund të mbillet edhe me farën e bimëve

frytdhënëse, dhe është vaditur me gjakun e pastër të luftëtarëve të lirisë, aq sa nuk është vaditur dot me ujë, le të jetë e të mbetet obelisku kombëtar shqiptar;

12. Jemi shqiptarë, të jemi gjithmonë të bashkuar për të krijuar të tashmen dhe për ta siguruar të ardhmen;

13. Shqiptarët kanë qenë dhe do të jenë përjetësisht njerëz që i bëjnë kurban të gjitha, me shtëpi, me mall, me katandi dhe marrin malet, bëjnë ushtri dhe luftojnë kundër paudhësive e kundër barbarizmave të ushtrisë e të policisë serbo-sllave, si dhe kundër pushtuesve të tjerë. Luftëtarët e lirisë kanë besuar, besojnë dhe do të besojnë, se vetëm kështu mund ta dëbojnë pushtuesin serb nga Kosova, duke u dhënë një mësim model të gjithë kombeve të shtypura;

14. Të ndalohen serbët, që të groposnin përgjithnjë ndjenjat atdhetare të popullit të Kosovës, për të siguruar përjetësisht pushtetin në këto toka të begatshme që janë shqiptare, këtë do ta bëjmë me luftën tonë pa kompromis;

15. Të mos zbrapsemi as para tendencës së kolonizimit gradual, as para forcës brutale të pushtetit të organizuar shtetëror të armikut serb të ulur në trojet tona, të luftojmë dhe të fitojmë;

16. Të luftojmë për të mbrojtur familjet tona;

17. Të luftojmë me vetëmohim që tokën dhe nëntokën tonë ta punojmë vetë, tash frytëzojmë vetë dhe ta gëzojmë vetë;

18. Të luftojmë për ta fituar luftën, të kemi lirinë, të çlirojmë edhe

gjuhën tonë, që të arrijmë të bëhemi popull i arsimuar në gjuhën e lirë kombëtare;

19. Të luftojmë për ta fituar lirinë, për të bërë që shkencëtarët e Kosovës të mos privohen më nga e drejta për të botuar veprat e tyre, që trajtojnë trashëgiminë historike-kulturore të kombit shqiptar, që djemve dhe vajzave tona të mos u privohet e drejta të shkollohen në gjithë hierarkinë shkollore, në gjuhën amtare dhe me mendësi shqiptare;

20. Të luftojmë për të arritur të mos lejojmë që të kemi mungesa të elementeve të barazisë me kombet e tjera, të mos diskriminohemi për përkatësi kombëtare, të mos na refuzohet dialogu me popullin tonë, me kombet e tjera, me politikën dhe diplomacinë botërore;

21. Të luftojmë për të ndaluar njëherë e mirë spastrimet e mëtejshme të Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit dhe Pollogut nga shqiptarët, që gjuhën tonë ta përdorim për të shprehur atë që duam, që të ndërtojmë ashtu si duam, që të vulosim e të firmosim shqip, që vendet tona t'i thërrasim me emrat e lashtë të gjuhës tonë, që popujt e tjerë t'i emërtojmë shqip dhe t'i komunikojmë me ta shqip, që djemtë e vajzat tona t'i emërtojmë me emrat tonë të etnitetit të lashtë, që pas emrave e mbiemrave tanë të mos vëmë më kurrë prapashtesën “viç”, që djemtë tanë të punojnë në vatrën e tyre, që u lejon mundësinë të jenë edhe krenarë edhe të pasurohen, për të mos marrë më kurrë rrugët e botës për një copë bukë. Për këto të jemi të gatshëm të luftojmë në çdo kohë

dhe të bëjmë sakrificat më të mëdha deri sa të japim edhe jetën tonë;

22. Të fitojmë luftën e lirinë për të bërë që të jemi pjesë e familjes së qytetarëve të lirë të botës, duke respektuar kombet e tjera dhe në asnjë rast të mos përfitojmë për vete në dëm të tyre, ashtu siç dëshirojmë dhe luftojmë, që për vete të kemi të drejta për ekzistencë dhe progres njerëzor e paqësor, të dëshirojmë të njëjtën gjë edhe për kombet e tjera, dhe kur të kemi mundësi të luftojmë që edhe ata të kenë atë që u takon, sikurse edhe ne, të mbrojmë lirinë tonë dhe të kombeve të tjera, të drejtën për vetëvendosje, për të jetuar në paqe, siguri e stabilitet dhe për të ndërtuar ardhmërinë;

23. Të luftojmë me shumë forcë, pasi pa përdorimin e forcës së armës, asnjëherë armiqtë nuk na e kanë dëgjuar zërin. Prandaj, edhe në momentet e luftës çlirimtare të Kosovës, faktorit politik shqiptar i dha vitalitetin e duhur dalja në skenën e luftës së UÇK-së, sepse, në kushtet tona, vetëm me ndihmën e forcës së organizuar ushtarake mund dhe do të mundësojmë ndreqjen e padrejtësive ndaj kombit shqiptar, si dhe do të shpëtohet Kosova nga copëtimi i planifikuar me hollësi nga pushtuesi serb, që synon serbizimin e saj. T'ia njohim vlerën forcës duke vlerësuar edhe urtësinë e qytetarinë;

24. Të luftojmë që të mbyllet njëherë e mirë procesi i mendësisë perandorake të Serbisë, për të vërtetuar edhe një herë se një shtet që ndërtohet e zgjerohet mbi masakrat ndaj të tjerëve, nuk mund

të ekzistojë gjatë dhe nuk mund të ketë dhe të ndërtojë të ardhme. Vetëm kështu bëhet e mundshme që të evropianizohemi, pasi një vend i pushtuar, siç është Kosova dhe trojet e tjera shqiptare, nuk mund të punojë për horizontet evropiane. Është kuptuar qartë se, në radhë të parë, duhet të luftojmë për t'u çliruar nga pushtimi, për të vendosur në vend nderin, dinjitetin dhe identitetin tonë, që i kemi të nëpërkëmbur;

25. Të luftojmë që të mos lejojmë të vazhdojmë më tragjedia e Kosovës, që është rezultati i një plani të hollësishëm dhe të paramenduar të serbëve, për sulm mbi një popull për përkatësinë etnike dhe fetare të tij, sulm i cili bazohet në filozofinë e përfitimit të tokave, duke shfarosur banorët etnik;

26. Të luftojmë që të bëjmë ta kuptojnë të gjithë, se detyra e njeriut është të ndërtojë jetën, të mbrojtë jetën, të pasurojë jetën dhe të ngrejë në pedestal mbrojtjen e vlerave hyjnore të njeriut, që është produkt i dashurisë dhe nuk lind kurrë nga urrejtja.

Këto parime, sa qytetare, aq edhe logjike, janë ato mbi të cilat janë mbështetur programet dhe planet politike e ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat kanë qenë të detyrueshme për të gjithë luftëtarët e asaj ushtrie.

A ka program për krim në këto parime?

A mund të jetë Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale një udhëheqje lufte që vendos si standard parime të tilla për të gjithë luftëtarët e ushtrisë që udhëheq? (Vijon)





QEVERIA NUK PËRKRAH EDHE NJË TËRHEQJE TË MJETEVE NGA TRUSTI

Tërheqja e 30-përqindëshit të Trustit, në dorën e deputetëve

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se nuk e përkrah nismën e Kuvendit të Kosovës për tërheqjen e 30 për qind të mjeteve nga Trusti. “Tërheqja e mjeteve nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë, pasi që edhe vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët”, ka njoftuar qeveria. Deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, i cili e ka iniciuar këtë nismë për tërheqjen e mjeteve nga Trusti, ka theksuar se tashmë kjo mbetet në duart e deputetëve. Ai beson se deputetët do të votojnë me integritet për kërkesën e qytetarëve për t’ua mundësuar atyre tërheqjen e mjeteve nga Trusti

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 22 PRILL - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se nuk e përkrah nismën e Kuvendit të Kosovës për tërheqjen e mjeteve nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës që njihet edhe si Trust. “Tërheqja e mjeteve nga Trusti nuk ndihmon kategoritë në nevojë pasi që edhe vetë përqindja e fondit pensional të tyre është e ulët. Me kursimin e pleqërisë nuk duhet abuzuar dhe veprimin e tillë duhet konsideruar si të mangët”, thuhet në njoftimin e Qeverisë së Kosovës pas një mbledhjeje në mënyrë elektronike.

Ekzekutivi që udhëhiqet nga Albin Kurti ka njoftuar se është afër qytetarëve për të “ndihmuar përmes rishpërndarjes, rritjes së punësimit, rritjes së mbështetjes në skemat sociale, për fëmijët, gratë dhe të rinjtë, si dhe për fermerët e ndërmarrësinë e vogël

e të mesme”.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), më e madhja parti opozitare, në mars kishte iniciuar nismën legislative për tërheqjen deri në 30 për qind të kursimeve pensionale. Ata që kanë deri në 20 mijë euro - 25 për qind, nga 20 mijë deri 30 mijë - 20 për qind. Sipas propozimit, për kontributpaguesit që kanë kursime pensionale në shumën prej 30 mijë eurosh - 15 për qind dhe ata mbi 40 mijë euro - 10 për qind të shumës. Këtë propozim PDK-ja e ka dërguar në Kuvend më 9 mars dhe i njëjti prite të vendoset në rend dite nga kryesia e Kuvendit. “Neglizhencë dhe papërgjegjësi e qeverisë në raport me kërkesën e qytetarëve për tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Në ditën e fundit, natën vonë, qeveria i thotë jo kërkesës së qytetarëve për Trustin”, kështu ka thënë deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, i cili ka propozuar amendamentin për tërheqjen e mjeteve

pensionale nga Trusti.

Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës për përgjigje negative nuk ka pasur nevojë ta vonojë projektligjin për Trustin 30 ditë. Haxhiu ka thënë se tashmë kjo çështje është në duart e deputetëve. “Kjo është neglizhencë dhe papërgjegjësi e qeverisë në raport me krizën ekonomike që i ka kapluar qytetarët. Për më tepër, është zvarritje e qëllimshme për kalkulime të dobëta politike. Kur dihet se Projektligji për Trustin do të ketë impakt pozitiv në buxhetin e Kosovës dhe në jetën e qytetarëve, pse qeveria nuk e ka mbështetur është e pakuptimtë?! Unë nga data 09.03.2022, kur e kam protokolluar Projektligjin për Trustin, çdo ditë kam biseduar me shumicën e deputetëve të Kuvendit. Besoj shumë se do të votohet Projektligji për Trustin në Kuvend. Nga nesër Projektligji për Trustin është në dorën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës

dhe besoj se deputetët do të votojnë me integritet për kërkesën e qytetarëve për t’ua mundësuar tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Kërkesa është e qytetarëve. Deputetët janë të popullit!”, ka deklaruar Haxhiu.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka reaguar ndaj vendimit të qeverisë për të mos e përkrahur nismën për tërheqjen e mjeteve nga Trusti. Tahiri ka thënë se ky është edhe një gabim i radhës i qeverisë Kurti. “Qeveria e Kosovës është humbur dhe tjetërsuar në petkun e pushtetit, ndërsa hallet dhe kërkesat e qytetarëve i trajton vetëm në fushatë zgjedhore. Qeveria e ka shumë gabim që nuk e përkrah nismën legislative të Kuvendit të Republikës së Kosovës për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës. Si grup parlamentar do të bëjmë çmos që ta mundësojmë tërheqjen e 30 për qind të mjeteve nga Trusti. Tërheqja e kursimeve nga trusti, sidomos në kohën kur vendin e ka përfshirë kriza ekonomike, është shumë e nevojshme për këndellje të ekonomisë dhe familjeve të Kosovës. Pra, duhen shfrytëzuar të gjitha burimet, të gjitha alternativat, duke shfrytëzuar në këtë rast edhe Trustin, për t’u dalë

në ndihmë qytetarëve. Mospërkrahja e qytetarëve në këtë kohë të goditjeve të mëdha ekonomike tregon se kemi qeverisje pa qeveri”, ka thënë Tahiri.

Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, ka theksuar se brenda dhjetë ditësh ose dy javësh Projektligji për Trustin vjen në seancë, e aty do të ketë lexim të parë dhe më pas do të vijë për votim edhe leximi i dytë. “Tërheqja e mjeteve nga Trusti është kërkesë e qytetarëve të Kosovës për ta tejkaluar krizën e rëndë ekonomike. Ne si deputetë, përderisa nuk kemi mundësi t’i ngrehim pagat e qytetarëve, nuk kemi zgjidhje tjetër vetëm t’i përgjigjemi kësaj kërkesë dhe ta mbështesim me votë. Është e drejtë e qytetarëve të kenë qasje në kursimet e tyre në këtë krizë me të cilën po përballen”, ka deklaruar deputetja Musliu.

Qytetarët e Kosovës kanë pasur të drejtë që t’i tërhiqin kursimet e tyre nga Trusti pas një vendimi të marrë më 2020. Ky vendim ishte marrë për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të familjeve në Kosovë pas shpërthimit të pandemisë së koronavirusit. Nga Trusti ishin tërhequr afro 200 milionë euro nga mbi 420 mijë kontributpagues.

Presidenti i Letonisë: E mbështesim Kosovën në BE dhe NATO

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Me ftesë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, me nderimet më të larta shtetërore është prituri të premten në vizitë zyrtare presidenti i Republikës së Letonisë, Egils Levits. Pas takimit dypalësh, të dy presidentët në oborrin e Presidencës kanë mbjellë drurin e miqësisë për t'i ruajtur dhe

kultivuar më tej marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërshtetërore. Në konferencën e përbashkët për medie presidentja Osmani ka përmendur nderin e veçantë për Kosovën që ta mirëpresë për herë të parë presidentin Levits e që është, njëkohësisht, vizita e parë e kreut të shtetit letonez në shtetin tonë. "Me presidentin Levits kishim diskutime

përmbajtjesore dhe produktive. Shpreha dëshirën tonë të fortë për të ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, por edhe në fushën e bashkëpunimit ekonomik, digjitalizimit dhe në fusha të tjera në dobi të dy popujve tanë" ka thënë Osmani. Presidentja Osmani ka theksuar se kjo vizitë përkon

me një periudhë të trishtë për Evropën, ku Ukraina po ballafaqohet me një luftë të tmerrshme të nisur nga Rusia. "Republika e Kosovës mbështet plotësisht pavarësinë dhe shtetësinë e Ukrainës, gjë që është reflektuar edhe në vendimet e marra nga institucionet tona, të bashkërenditura me ato të Bashkimit Evropian", ka thënë

presidentja Osmani, duke shtuar se dy vendet do të vazhdojnë të kontribuojnë për paqe dhe stabilitet në kontinentin tonë. Ndërkaq presidenti Levits ritheksoi mbështetjen e plotë të Republikës së Letonisë për integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian dhe NATO, njëkohësisht mirëpret anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.



PDK-ja: Ambasadori ynë në Kroaci shërben si një sekser i kryeministrit Kurti

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka reaguar pas raportimit të fundit të medieve slllovene për përfshirjen e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, në një aferë të madhe korruptive, në të cilën janë të përfshira edhe kompani serbe.

Në një konferencë për medie, Tahiri ka thënë se kjo aferë nxjerrë në pah që ambasadori Berishaj, që në qeverinë Kurti 1 ishte këshilltar i kryeministrit, shërben si sekser i Albin Kurtit në raportet me kompaninë serbe "Gen". "Kompania 'Gen', sipas raportimeve të deritanishme, i ka paguar ambasadorit tonë rreth 600 mijë euro. Po ashtu, gjatë periudhës së fundit dyvjeçare, kur në KEK është vendosur një menaxhment i ri nga qeveria



Kurti 1 dhe ka vazhduar me qeverinë Kurti 2, kanë bashkëpunuar me këtë kompani. Dega e kompanisë 'Gen' në Serbi i ka shitur Republikës së Kosovës energji elektrike dhe ka blerë energji

elektrike nga Republika e Kosovës. Pra kjo është jashtëzakonisht skandaloze, që ambasadori ynë shërben si një sekser i kryeministrit tonë, mes tij dhe mafies serbe energjetike, i cili me çdo kusht pengon

themelimin e Komisionit Hetimor", ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se zbulimi i kësaj afere e bën të domosdoshëm themelimin e Komisionit Hetimor për krizën energjetike në Kosovë. "Ne duam të shohim

se sa për qind e këtyre mjeteve të ndara nga buxheti i Kosovës, taksave të qytetarëve, mbi 100 milionë euro, i ka përfituar kompania 'Gen' me bazë në Serbi, në të cilën ambasadori ynë shërben si këshilltar", ka theksuar Tahiri. Sipas Tahirit, pas kundërshtimit të mazhorancës për hetimin e mënyrës së menaxhimit të krizës energjetike, qenka një ndërmarrje e përbashkët kriminale. "As vetë nuk e kemi besuar se deri sot zyrtarë të lartë të shtetit të Kosovës mund të jenë të përfshirë në afere të tilla korruptive ndërkombëtare. Pra, ne sot e shohim arsyen e vërtetë të bllokimit të formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar për të hetuar çdo transaksion të shpenzimit të taksave të qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë Tahiri.

Konventa e LDK-së mbahet më 29 dhe 30 prill

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë të premten se kanë marrë vendim që ta thërrasin konventën programore të partisë "Lidhja për të ardhmen" më 29 dhe 30 prill të këtij viti.

Abdixhiku ka thënë se do të jetë platformë gjithëpërfshirëse e temave më me interes për Kosovën. "Në këtë konventë programore do të ftohen t gjithë

anëtarët e kuvendit të LDK-së, anëtarët e këshillit të përgjithshëm të LDK-së, deputetët, kryetarët e komunave nga radhët e LDK-së, asamblistët e pushteteve lokale të LDK-së, kryetarët e degëve të kryesisë, anëtarët e forumeve rinore, forumeve të gruas dhe të gjitha strukturave tona në një punim dyditor ku do ta nisim organizimin e programit tonë politik dhe qeverisës për Kosovën", ka thënë Abdixhiku.

Ai ka thënë se do të kenë panele diskutuese në temat më të rëndësishme të Kosovës. "Pas konventës do t'i nisim konsultimet e brendshme me qytetarët nëpër çdo qytet të Kosovës dhe grupe të interesit, mjek, polic, sportist, artist etj., për t'i dëgjuar brengat, mendimet, pikëpamjet e tyre, dhe do të nisim konsultime me ekspertë të fushave e gjithandëj", ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.



Nis plotësim-ndryshimi i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Të premtën kanë filluar punimet e grupit punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këtë takim të parë të këtij grupi punues ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, pranë përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, partnerëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, trajtoi rëndësinë që ka plotësim-ndryshimi i këtij ligji, duke marrë shkas nga mangësitë të cilat janë shpërfaqur deri tani në këtë drejtim, përkritazi me ligjin aktual. Përgjegjësia, disiplina dhe llogaridhënia e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërlihet me këtë ligj i cili synohet të hartohet me standardet më të mira për të prodhuar edhe efikasitet të plotë në këto qëllime.

Ministrja Haxhiu ka theksuar para të pranishmëve se arsyeja e fillimit të ndryshimeve të tilla është identifikimi i shumë problemeve të ligjit ekzistues dhe gjithashtu, nevoja për të pasur legjislacion të kompletuar i cili do t'i rregullonte profesionalisht procedurat të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësinë dhe disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre. Përpos kësaj, ky proces i ndryshimit të ligjit gjen bazën në raportin e Kuvendit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit i cili rekomandon plotësimin dhe ndryshimin e ligjit. Bazuar në gjetjet e raporteve të shumta vendore, janë evidentuar disa probleme me ligjin ekzistues, filluar nga ato teknike, deri te problemet më përmbajtësore si: sqarimi i përkufizimeve të përdorura në ligj, përmbajtja e




ankesës ndaj gjyqtarit dhe prokurorit, çështjet lidhur me masat disiplinore dhe pasojat e shqiptimit të tyre, aplikimi i mjeteve

juridike dhe probleme të tjera të evidentuara. Plotësim-ndryshimi i këtij ligji u konsiderua si pjesë e rëndësishme

në kuadër të reformave në sistemin e drejtësisë nga i cili pritet të përgatitet me profesionalizëm dhe të sjellë rezultate konkrete.

Kryetari i Gjilanit u bënë thirrje qytetarëve t'i bashkohen aksionit të pastrimit



GJILAN, 22 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, nëpërmjet një konference për medie, ka hapur të premtën kampanjën e pastrimit "Green & Clean" e cila do të zgjasë deri më 5 qershor. Hyseni u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Gjilanit që të bashkohen në këtë kampanjë "Green & Clean" me qëllim që ambienti që na rrethon e ajri që e thithim të jetë sa më i pastër. "Qëllimi ynë është që ta bëjmë

kampanjën edhe vetëdijësuese, edhe të pastrimit. Përveç të tjerash, përfshihet edhe mbjellja e drunjve dekorativë, largimi i deponive ilegale, vendosja e koshave të mbeturinave, pastrimi i shkollave, institucioneve e rrugëve", ka thënë Hyseni, duke shtuar se qëllimi final është që kjo kampanjë të zhvillohet edhe në vitet e ardhshme. "Përpos pjesës së largimit të mbeturinave e pastrimit të hapësirave, është edhe mesazhi sensibilizues e thirrja që

bashkë me qytetarët, inspeksionin e policinë, ta parandalojmë krijimin e deponive ilegale e ndotjen e ambientit", ka shtuar kreu i Gjilanit. Më pas kryetari Hyseni, nënkryetarja Morina-Bunjaku, së bashku me përfaqësuesit e institucioneve lokale, "Eco-Higjienën", policinë e të rinjtë dhe të rejtat, kanë vazhduar pastrimin e parkut të qytetit dhe pastrimin e hapësirave të institucioneve komunale.

Policët ligjërojnë në shkollat e Prizrenit për dhunën në familje

PRIZREN, 22 PRILL (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren, Sektori për Komunitete në stacionin policor në Prizren dhe në Dragash, në zbatim të Strategjisë së udhëhequr nga inteligjenca dhe policimi në bashkësi, kanë realizuar aktivitetet e planifikuara në bashkëpunim me drejtoritë

komunale të arsimit në Prizren dhe Dragash, ku kanë mbajtur ligjëratat me temën "Dhuna në familje", me nxënës të shtatë shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në komunën e Prizrenit dhe Dragashit. "Këto ligjëratat në shkolla kanë për qëllim që nxënës të pajisen me njohuri sa iu përket sjelljeve joshqërore të

shfaqura edhe te fëmijët për format dhe llojet e dhunës në familje si dhe mundësinë dhe kontributin që edhe ata mund të japin në parandalimin e kësaj dukurie", ka njoftuar Policia e Kosovës. Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren do t'i vazhdojë ligjëratat e tilla edhe në shkollat e tjera në rajonin e Prizrenit.



Lumezi dorëzon detyrën e kryeprokurorit të Shtetit te Besim Kelmendi

PRISHTINË, 22 PRILL (ER) - Kryeprokurori i deritanishëm i Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka dorëzuar detyrën ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi.

Gjatë ceremonisë së pranid-dorëzimit, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryesuesi, zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe u. d. drejtori i Sekretariatit të KPK-së, kryeprokurori i deritanishëm Lumezi, i ka uruar suksese dhe mbarësi u. d. kryeprokurorit Kelmendi për ushtrimin e detyrave kushtetuese dhe ligjore gjatë udhëheqjes së institucionit të Prokurorit të Shtetit. Ndërsa u. d. kryeprokurori Kelmendi e ka

falënderuar kryeprokurorin e deritanishëm, Aleksandër Lumezi, për punën, angazhimin dhe profesionalizmin e treguar përgjatë ushtrimit të mandatit kushtetues si kryeprokuror i Shtetit i Republikës së Kosovës.

Ky pranid-dorëzim vjen pas përfundimit të mandatit kushtetues shtatëvjeçar të kryeprokurorit të deritanishëm të Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili ishte emëruar në këtë pozitë më 21 prill 2015.

Më 6 prill Këshilli Prokurorial i Kosovës ka votuar në mënyrë unanime Blerim Isufajin për kryeprokuror të ri të shtetit.

Lidhur me këtë votim të KPK-së

janë shprehur të pakënaqur ambasadori amerikan, Jeff Hovenier, shefi i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ambasadori gjerman Jorn Rohde, si dhe OJQ-të në Kosovë. Megjithatë ishte bërë thirrje për një proces të drejtë dhe meritore, ambasadorët e huaj në Kosovë dhe shoqëria civile kanë deklaruar se KPK i ka shpërfillur këto parime. Ndërkaq, të enjten e 21 prillit, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka caktuar Besim Kelmendin ushtrues detyre i kryeprokurorit të shtetit. Në mbledhjen e KPK-së është vendosur që Kelmendi ta ushtrojë këtë detyrë deri në një vendim të ri të këtij institucioni.



Me rastin e Ditës së Tokës mbahen aktivitete për edukimin mjedisor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 PRILL - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 22 Prillit - Ditës së Tokës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës gjatë kësaj jave ka realizuar vizita nëpër disa shkolla të mesme të ulëta nëpër komunat e Kosovës.

Gjatë këtyre aktiviteteve janë vizituar dhjetëra shkolla të mesme të ulëta në komunat: Klinë, Pejë, Graçanicë, Vushtrri, Ferizaj, Kaçanik, Gjilan, Prishtinë dhe Fushë-Kosovë.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte shpërndarja e materialeve promovuese, mbajtja e ligjëratave dhe punëtorive me nxënës me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit

dhe edukimit për mbrojtjen e mjedisit.

Aktivitetet e AMMK-së janë mirëpritur nga shkollat dhe kanë zgjuar interesim te nxënësit të cilët njëkohësisht kanë planifikuar dhe realizuar aktivitete të tjera për ta shënuar 22 Prillin - Ditën e Tokës.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës do ta vazhdojë angazhimin e saj për ndërgjegjësimin dhe edukimin mjedisor në të ardhmen edhe në shkolla të tjera me aktivitete të ndryshme.

Me rastin e shënimin të Ditës së Tokës, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka vizituar procesin e mbjelljes së 33 mijë fidanëve në komunën e Dragashit nga projekti i FAO-s në Kosovë; një partner i Ministrisë së



Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. "Në kuadër të pyllëzimeve që realizon Agjencia e Pyjeve e Kosovës, deri më tani janë mbjellë 309 30 hektarë, përkatësisht 773 321

fidanë të drunjve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se nuk kanë tjetër planet andaj, sipas Pecit, duhet të përkujdesemi që të mos

shkaktojmë dëme aty ku mund të kontribuojmë për përmirësim të situatës. "Me veprime të vogla, por të herëpashershme, mund t'i prekim çështjet klimatike dhe t'i adresojmë ato qoftë përmes politikave që mbrojnë biodiversitetin, qoftë përmes aksioneve të rregullta të pyllëzimit", është shprehur Peci. Ai ka thënë se ministria që drejton synon që së bashku me partnerët e saj ta arrijnë shifrën e mbi një milion drunjve të mbjellë brenda një viti.

Ministri Peci ka thënë se gjithsej përmes projektit të FAO-s janë në proces të pyllëzimit afro 50 hektarë me rreth 140 mijë fidanë në komunën e Mitrovicës, Shtërpcës dhe Suharekës, krahas komunës së Dragashit.



Klinika Infektive nuk ka pacientë të konfirmuar me Covid

Prishtinë, 22 prill (ER) - Për herë të parë që nga fillimi i pandemisë Covid-19, Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare e Kosovës nuk ka të shtrirë asnjë pacient të konfirmuar me Covid-19.

Në Spitalin e Gjakovës është i shtrirë një pacient i konfirmuar me Covid-19.

Sa iu përket pacientëve post-Covid-19, Klinika Infektive po i trajton tre të tillë.

Klinika Infektive para disa

muajve, pas qetësimin të situatës me Covid-19, ka filluar të ofrojë shërbime shëndetësore edhe për pacientët me sëmundje të tjera ngjithëse. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se pas 736 testeve, 14 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 në 24 orët e fundit dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të premtën janë shëruar 10 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224 359. Në

total numri i rasteve aktive është 438.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 163 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 155 doza të vaksinës.

Deri më sot 821 612 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 101 104 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



PDK-ja dorëzon kallëzim penal ndaj anëtarëve të bordit të ZRRE-së

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 PRILL - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka dorëzuar të premtën kallëzim penal për anëtarët e Bordit të ZRRE-së në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për moszbatim të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për pezullimin e zbatimit të vendimit për shtrenjtimin e energjisë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Bajrush Xhemajli, në një konferencë për medie, pas dorëzimit të padisë, tha se ZRRE, përkundër detyrimit ligjor për ta zbatuar vendimin e gjykatës, dezinformoi opinionin publik, se gjoja ky vendim nuk mund të zbatohet pasi ata do të ankohen në Gjykatën e Apelit. "Në cilësi të sekretarit të përgjithshëm të PDK-së, së bashku me përfaqësuesin e autorizuar, avokatin Faton Fetahu, duke vepruar në emër të Partisë Demokratike të Kosovës,

parashtrua kallëzimin penal kundër bordit të Zyrës për Rregullatorin e Energjisë, i cili nga data 8 prill i këtij muaji dështoi ta zbatojë aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, i cili aktvendim pezulloi vendimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike deri në përfundim të procesit gjyqësor në padinë e PDK-së, të cilën e kemi bërë kundër vendimit të ZRRE-së. Pasi ZRRE-ja mori vendim në fillim të muajit shkurt për shtrenjtimin e energjisë elektrike, PDK-ja, duke vepruar në mbrojtje të interesit të qytetarëve të Kosovës, konsumatorëve familjarë të energjisë elektrike, ka parashtruar padi për shfuqizimin e vendimit të ZRRE-së. Dhe krahas kësaj padie, ne kemi bërë edhe kërkesë për shtyrjen, përkatësisht pezullimin e vendimit të ZRRE-së, deri në shqyrtimin dhe vendosjen meritorie të Padisë, me qëllim që të evitohen pasojat e mëdha dhe humbjet që ky vendim po u shkakton qytetarëve tanë", ka thënë Xhemajli.



Përkundër që PDK-ja ka bërë thirrje publike për zbatimin e këtij vendimi të gjykatës, ZRRE-ja ka vazhduar ta faturojë energjinë me tarifa të shtrenjta deri në 109 %, duke u shkaktuar dëme

financiare 350 mijë familjeve të Republikës së Kosovës. "Krejt kjo paligjësi po kalon në heshtje nga kryeministri dhe tërë mazhoranca në qeveri e parlament, që tregon se janë në sinkron të plotë me ZRRE-në. Bordi i ZRRE-së ka vendosur të veprojë mbi ligjin e mbi vendimin gjyqësor, prandaj ne këtë nuk do ta tolerojmë dhe nuk do të ndalemi së kërkuar drejtësi për qytetarët të cilët po plaçkiten", ka thënë Xhemajli. Ai ka theksuar se PDK-ja mirëpret fillimin e hetimeve penale ndaj bordit të ZRRE-së, sepse beson në shtetin ligjor dhe demokratik.

Ndërkaq Faton Fetahu, avokat i PDK-së, ka pohuar se nga ky muaj kur qytetarët e Kosovës t'i pranojnë faturat e energjisë me rritje të çmimeve, ata kanë të drejtë ligjore të bëjnë padi individuale ndaj KESCO-s dhe ZRRE-së për shkak se, sipas tij, ky faturim tanimë është në kundërshtim me vendimin e gjykatës, rrjedhimisht është pa bazë ligjore.

Guvernatori Mehmeti takoi drejtuesit e lartë të FMN-së dhe të BB-së

UASHINGTON, 22 PRILL (ER) - Në kuadër të takimeve pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, të cilat janë duke u zhvilluar në Uashington, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka takuar zëvendës drejtorin menaxhues të FMN-së, Bo Li, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë, me theks të veçantë për qëndrueshmërinë e sektorit financiar dhe për zhvillimet e avancuara në këtë sektor.

Mehmeti ka uruar zëvendës drejtorin menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar për pozitën si dhe e ka falënderuar këtë institucion për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës, në këtë rast BQK-së, përderisa zëvendës drejtori menaxhues i Fondit Monetar

Ndërkombëtar, Bo Li, ka theksuar mbështetjen e mëtutjeshme për BQK-në edhe në të ardhmen.

Guvernatori Mehmeti është takuar edhe me drejtorin e Departamentit Evropian të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Alfred Kammer, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimet e fundit makroekonomike si dhe për zhvillimet në sistemin financiar të Kosovës. Po ashtu, Mehmeti është takuar edhe me zëvendës presidenten e Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore, Anna Bjerde.

Në këtë takim guvernatori Mehmeti e informoi Bjerden për zhvillimet e fundit në sistemin financiar të Kosovës dhe e falënderoi për përkrahjen e Bankës Botërore ndaj BQK-së përmes projekteve të ndryshme me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit financiar në Kosovë.



Kosova përfiton 51 milionë euro nga Banka Botërore



UASHINGTON, 22 PRILL (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe zëvendës presidentja e Bankës Botërore për Evropë dhe Azi Qendrore, Anna Bjerde, në javën e takimeve pranverore në Uashington kanë nënshkruar marrëveshjen për financimin e Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe Rritje të Qëndrueshme (DPF).

Ky financim kap vlerë prej 51 milionë eurosh dhe mbështet prioritetet e qeverisë për periudhën 2021-2025, që

përfshijnë transparencën fiskale, mbështetjen e sektorit privat, si dhe tranzicionin energjetik.

Në lidhje me marrëveshjen e nënshkruar, ministri Murati u shpreh se reformat e mbështetura nga ky program riafirmojnë faktin se strategjia jonë është e ngritur mbi themele të qëndrueshme fiskale dhe është në funksion të zhvillimit afatgjatë, duke konfirmuar edhe një herë përkushtimin e qeverisë për realizimin e këtyre objektivave.

Në këtë kontekst, mekanizmi DPF do t'i mbështesë masat që synojnë

rritjen e transparencës për menaxhimin e financave publike në raport me menaxhimin e borxhit publik. Po ashtu, programi mbështet përmirësimin e kushteve të të bërit biznes për sektorin privat, duke thjeshtësuar procedurat për inspektime dhe duke zvogëluar barrën administrative për bizneset. Më tutje, me anë të këtij programi ka filluar edhe krijimi i bazës që mbështet investimet në energji të ripërtëritshme, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Dyshimeve për keqpërdorim, s'u përgjigjen zyrtarët e Bibliotekës Kombëtare

EPOKA
ERE **Faton DERRMAKU**

Ka një muaj kohë që redaksia e gazetës "Epoka e re" i ka dërguar Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" kërkesë për qasje në dokumente publike për lëndën "Botimi i materialeve për nevoja të BKK-së", me numër të prokurimit 90900-21-9083-2-3-6, të publikuar në KRPP me datë 07.12.2021 dhe ende nuk i është lejuar qasja në këtë lëndë, për të cilën dyshohet se ka keqpërdorim.

Rastin për keqpërdorim të kësaj lënde në gazetën "Epoka e re" e kanë paraqitur operatorët ekonomikë të cilët për këtë lëndë i kanë dhënë ofertë Bibliotekës Kombëtare, por kontrata është nënshkruar me një operator tjetër ekonomik që ka ofruar çmim më të ulët. Por, operatorët ekonomikë konkurrentë janë ankuar se me rastin e shpalljes së kësaj lënde nga biblioteka për "Botimin e materialeve për nevoja të BKK-së" në uebfaqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) është bërë mashtrim. Mashtrimi, sipas tyre, ka ndodhur me rastin e botimit të librit "Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri".

Për këtë libër zyra e prokurimit e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, me rastin e publikimit të lëndës në KRPP, ka dhënë këto specifika për shtypin e librit "Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri": "Shtypi i librit Formati B5, faqe 465-490; Kopertina: shtypi me ngjyra (color) në letër konzdrukt Mat 350 gr. me platifikim Mat; Brendia: shtypi b/z në letër 'shamoa'80 gr; Lidhja e fortë me qepje me penj; Shtypi i mbështjellësit të librit në konzdrukt Mat 160 gr. kolor dhe logoja e shtypur në "Termo shtyp" me ngjyrë ari; Lidhja e fortë me rikne harkore e cila mbanë harkun të fortë; Kapitali dhe shiriti ndarës".

Gazeta "Epoka e re" ka siguruar një kopje elektronike të këtij libri, i cili është i madhësisë B5, mirëpo ka vetëm 399 faqe, që i bie se një ekzemplar ka 65-90 faqe më pak sesa paraqitet në shpalljen në KRPP, kurse në total, për 500 ekzemplarë sa ka qenë njoftimi

për shtyp nga biblioteka, ka 32 500-45 000 faqe më pak.

Një operator ekonomik, i cili ka dashur të mbetet anonim, për gazetën "Epoka e re" është shprehur: "Po të jepte biblioteka informacion të saktë për botimin e atij libri, edhe për materialet e tjera, do të ofronim çmim edhe më të ulët sesa që ka ofruar operatori ekonomik me të cilin biblioteka e ka nënshkruar kontratën. Thjesht, jemi mashtruar dhe për këto raste zyrtarët e prokurimit dhe ata zyrtarë që i kanë përgatitur paramasat e lëndës duhet të japin përgjegjësi. Këtë lëndë duhet ta hetojnë krimet ekonomike. Ne në këtë rast shohim favorizim të operatorit fitues ekonomik".

Pasi ka marrë këtë ankesë, gazeta "Epoka e re" ka kërkuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" qasje në dokumentet publike të saj dhe në Departamentin e Pasurimit, që të vërtetuar sa faqe ka libri "Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri". Një muaj më parë bibliotekës nga gazeta i është dërguar kjo letër: "Të nderuar, dosjen që na keni dërguar e kemi parë në shpalljen e KRPP-së që disa muaj. Ne nuk kemi shprehur interesim për këtë dosje, se nuk kemi pasur ndër mend të ofrojmë këtë shërbim për bibliotekë. Ne e kemi kërkuar dosjen e operatorit ekonomik që i është dhënë kontrata nga Biblioteka Kombëtare. Duam të dimë sa ka kushtuar shtypi 'Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri', sa ekzemplarë janë shtypur dhe ku janë ata ekzemplarë. Nuk po e gjejmë asnjë askund. Janë shtypur apo nuk janë shtypur? I është bërë pagesa për 500 ekzemplarë sa shkruan në dosje apo për sa? Na duhet fatura e operatorit ekonomik.

Ju bëjmë me dije se në javën e kaluar këtë libër e kemi kërkuar në Bibliotekën Kombëtare, tek informacioni. Nuk e kemi gjetur aty. E kemi kërkuar edhe në Departamentin e Pasurimit. S'e kemi gjetur as aty. Zyrtarët e kësaj zyre na kanë njoftuar se ende s'i keni dorëzuar ekzemplarët e obligueshëm ani pse aty i keni marrë cipin dhe barkodin për



këtë libër. Dmth., vetë biblioteka nuk ka respektuar Ligjin për Veprimtari Botuese dhe Libër.

Më tutje, në dosjen që na keni dërguar dje, të cilën e kemi që disa muaj, i keni njoftuar operatorët ekonomikë se 'Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri' ka 465-490 faqe të formatit B5. I njëjti libër që kemi marrë në formatin pdf ka 399 faqe. Meqë këtë libër nuk po e gjejmë askund në treg, as në bibliotekën tuaj, kërkojmë nga ju ta shohim edhe kopjen fizike. Kemi pasur ankesa nga operatorët ekonomikë se Zyra e Prokurimit e Bibliotekës Kombëtare nuk ka dhënë përshkrime të sakta për këtë libër dhe për disa materiale të tjera të cilat i ka shtypur operatori ekonomik.

Ju lutemi, na dërgoni dosjen e nënshkruar me operatorin ekonomik dhe na lejoni qasje në Departamentin e Pasurimit për t'i parë të 500 ekzemplarët e librit për familjen Jashari që keni shtypur. Kërkojmë, gjithashtu, qasje në Departamentin e Pasurimit, të Katalogimit dhe të Informacionit konkretisht për botimin e këtij libri".

Pas heshtjes së zyrtarëve të saj, gazeta "Epoka e re" tri javë më parë nëpërmjet telefonit ka kontaktuar me asistenten e drejtorit të bibliotekës, Fazli Gajraku, e cila ka thënë: "Kërkesën tuaj e kemi marrë. Veç kini durim dhe prisni". Ende asnjë

përgjigje tjetër prej saj.

"Libri i kujtesës: familja Jashari në dritën e betejës për liri", i përgatitur dhe i botuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe i pajisur me cip dhe barkod po nga kjo bibliotekë, nuk gjendet as në Departamentin e Pasurimit, në të cilin një muaj më parë kemi qenë dhe e kemi kërkuar. Nuk gjendet as në uebfaqen e Bibliotekës Kombëtare

www.biblioteka-ks.org. Ky libër, edhe pse është promovuar më 28 nëntor 2021 në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, nuk gjendet brenda këtij institucioni. Në ditën e përrurimit të këtij libri, drejtori i Bibliotekës Kombëtare, Fazli Gajraku, i cili është edhe kryeredaktor i këtij libri, ka thënë se njëqind ekzemplarë të këtij libri do t'i dhurohen familjes së komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, por familjes së tij i është dhënë vetëm një ekzemplar. Pavarësisht prej përpjekjeve tona, për t'i parë 500 ekzemplarët që Biblioteka Kombëtare ia ka paguar operatorit ekonomik, nuk kemi gjetur asnjë ekzemplar në këtë objekt. Informacionet për shtypin e këtij libri biblioteka po i mban fshehtë.

Ndërkohë kemi marrë vesh se për këtë libër janë paralajmëruar edhe padi nga botues dhe gazetarë për Bibliotekën Kombëtare të Kosovës,

e cila ka skanuar shkrime të gazetave dhe të artikujve të gazetarëve, të historianëve, të publicistëve pa marrë prej tyre të drejtën për botim ashtu siç parashihet në Ligjin nr. 04/1-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Gazeta "Epoka e re" do ta hulumtojë edhe më tutje këtë rast. Të hënën për këtë rast do t'i paraqitet Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Departamentit për Qasje në Dokumente Publike, e cila mund të marrë masa ndëshkuese për bibliotekën sipas Ligjit nr. 06/1-081 për Qasje në Dokumente Publike. Në nenin 27 të këtij ligji, në lëndën "Dispozitat ndëshkimore", shkruhet: "1. Institucioni publik i cili në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, i pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave në qasje në dokumente publike dhe informata, dënohet me gjobë prej pesë mijë (5.000) deri dhjetë mijë (10.000) euro". Në këtë ligj parashihen dënime edhe për personin përgjegjës të institucionit publik. Ndër të tjera, edhe për personin fizik i cili e dëmton, e shkatërron, e fshehtë ose në ndonjë tjetër mënyrë ose formë e bën të paqartë informatën. Gjithashtu, në javën e ardhshme do të kontaktojmë edhe me Këshillin Drejtues të Bibliotekës Kombëtare dhe me zyrtarët e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Ministrinë e Kulturës.



promovim

Libri i Kujtesës
FAMILJA JASHARI
në dritën e betejës për liri


antika e gazetës dhe revistave të Kosovës
ditore 1991 - mars 1998

në Hollin e Bibliotekës,
më 28 nëntor 2021, në orën 11:00.

Neni 27

Dispozitat ndëshkimore

1. Institucioni publik i cili në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, i pamundëson, pengon ose kufizon realizimin e të drejtave në qasje në dokumente publike dhe informata, dënohet me gjobë prej pesë mijë (5.000) deri dhjetë mijë (10.000) Euro.
2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni, ndëshkohet edhe personi përgjegjës i institucionit publik, me gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri një mijë (1000) Euro.
3. Me gjobë prej pesëqind (500) deri dymijë (2000) Euro, ndëshkohet për kundërvajtje edhe personi fizik i cili e dëmton, e shkatërron, e fshehtë ose në ndonjë tjetër mënyrë ose formë e bën të paqartë informatën, rrjedhimisht dokumentin publik, me qëllim të pamundësimit të realizimit të së drejtës në qasje të dokumenteve publike, nga ana e kërkuarit të interesuar.
4. Për kundërvajtje nga paragrafi paraprak, me gjobë prej një mijë (1.000) deri dymijë (2000) Euro, ndëshkohet personi përgjegjës i institucionit publik kompetent.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova rikthehet me dy medalje nga Evropiani i Boksit 'Sofia 2022'

PRISHTINË, 22 PRILL - Ekipi i Kosovës në boks është përfaqësuar nga dy boksierë në Kampionatin Evropian U18 "Sofia 2022" që është zhvilluar në Bullgari. Kosova është përfaqësuar nga Taulant Jakupi

dhe Donat Sylja. Që të dy kanë fituar medaljet e bronzta në këtë evropian për të rinj. Në fazën e gjysmëfinale, Jakupi në kuadër të kategorisë deri në 86 kilogramë pësoi humbje kundër boksierit nga Italia,

Paolo Caruso. Në anën tjetër, Sylja në kuadër të kategorisë deri në 92 kilogramë u mposht në gjysmëfinale nga boksieri rumun Florian Ionita. Me këto humbje, të dy boksierët kosovarë nuk arritën ta prekin

finalen e kësaj gare, duke fituar dy medalje të bronzta. Dy medalje në mesin e 40 shteteve pjesëmarrëse me 402 boksierë është sukses i madh i boksit të Kosovës, ku më shumë se 25 shtete kanë mbetur pa medalje.



Skudrat që luftojnë për titull përballe atyre për mbijetesë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 22 PRILL - Skudrat që garojnë për titull të kampionës në BKT Superligën e Kosovës në futboll do të përballen me skudrat që luftojnë për mbijetesë. Sot (e shtunë) skuadra e parë në renditjen tabelore, Ballkani nuk ka punë të lehtë, pasi i shkon Ulpianës që po synon të sigurojë mbijetesën. Të përzgjedhurit e trajnerit Ilir Daja synojnë të marrin edhe tri pikë të reja që e dërgojnë edhe me afër titullit të kampionës. Ballkani është tetë pikë para përcjellësit të parë, Gjilanit.

E në anën tjetër, Ulpiana renditet në vendin e parafundit me 24 pikë dhe do



ta këtë të vështirë sigurimin e mbijetesës. Drita që pozicionohet e treta në tabelë me 52 pikë e pret

Malishevën. Gjilanasit janë kualifikuar në finale të Kupës, por edhe në kampionat do të mundohen që të përfundojnë

në pozitë sa më të lartë. Malisheva e Arsim Thaqit në këtë ndeshje do të tentojë një rezultat pozitiv, pasi është

afër për të siguruar mbijetesën në elitë. Llapi ka punë më të lehtë pasi i shkon Feronikelit në Drenas nga ku pritet të marrë edhe tri pikë të reja. Të dielën, Dukagjini e pret Gjilanin nga ku synon rezultat pozitiv. Në anën tjetër Gjilani është i vendosur të ndjek titullin deri në fund dhe në këtë ndeshje do të luajë për tri pikë. Ndeshja tjetër është ajo mes Prishtinës dhe Drenicës.

SUPERLIGA - Java e 30

Të shtunën takohen:
14:00 Drita - Malisheva
14:00 Ulpiana - Ballkani
14:00 Feronikeli - Llapi

Të dielën takohen:
13:30 Dukagjini - Gjilani
14:00 Prishtina - Drenica

Sonte takohen Trepça - Rahoveci



Prishtinë, 22 prill - Java e 28 e Art Motion Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë disa ndeshje interesante, por edhe do ta përcaktojë renditjen përfundimtare. Ndeshje interesante pritet të zhvillohet në mes të Trepçës dhe Rahovecit. Mitrovicasit kanë 18 fitore e nëntë humbje dhe synojnë vendin e dytë, që siguron gjysmëfinalen, kurse "Vreshtarët" janë në pozitën e shtatë dhe nëse humb Bashkimi, do të tentojë të renditet në vendin e gjashtë.

Rahovecasit kanë 11 fitore e 16 humbje. Të dielën përballen kampioni me nënkampionin, Golden Eagle Ylli-Peja, që u takuan edhe në finale të Ligës Unike, ku fituan pejanët 72:89, duke fituar trofeun e kësaj gare. Therandasit kanë siguruar vendin e parë me 21 fitore e gjashtë humbje, kurse pejanët kanë 18 fitore e nëntë humbje, aq sa kanë edhe mitrovicasit, që renditen në vendet dy, përkatësisht tre. Takimi i fundit për këtë xhiro është mes Prizrenit 16 dhe Prishtinës që,

me gjasë, do të luajnë edhe në çerekfinale të "play-off"-it. Prizrenasit kanë 42 pikë, kurse prishtinasit 41, andaj do të jetë një test para garave shtesë.

ART MOTION SUPERLIGA - Java 28

Të shtunën takohen:
20:30 Trepça - Rahoveci

Të dielën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Peja
20:30 Prizreni 16 - Sigal Prishtina

KOK-u mbulon shpenzimet e operimit të Nora Gjakovës

PRISHTINË, 22 PRILL - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, nën drejtimin e presidentit Ismet Krasniqi, mbajti mbledhjen e 12 të tij, në të cilën shqyrtoi pika të

ndryshme të rendit të ditës. Në këtë takim KOK-u mori vendi që t'i mbulojë shpenzimet e operimit të kampionës olimpike Nora Gjakova. "U vendos që kampionia

olimpike, xhudistja Nora Gjakova, të mbështetet me 3 000.00 euro për mbulimin e shpenzimeve të operimit", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Gjatë këtij takimi u vendos që

edhe xhudistja Flaka Loxha të dërgohet për rekomandim për shpërblim në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport pas suksesit në Kampionatin Evropian U-23.



Serena Williamsi dhe Lewis Hamiltoni kërkojnë ta blejnë klubin e Chelseat

LONDËR, 22 PRILL - Ish-numri 1 i tenisit botëror të femrave, Serena Williams dhe shtatë herë kampioni i notës në Formula 1, Lewis Hamilton, i janë bashkuar ofertës së Martin Broughton për t'i

blerë aksionet e klubit të Chelseas. Sipas asaj që raportojnë mediet botërore, dyshja kampione ka premtuar të kontribuojë me 10 milionë paund secili me misionin për ta ruajtur statusin kryesor të

"londinezëve". Hamiltoni dhe Williamsi kanë bërë investime të rëndësishme vitet e fundit. Blerja e aksioneve të Chelseas është ai i radhës, duke konfirmuar fitimet kolosale të grumbulluara gjatë

karrierës së tyre. Në garë për t'i blerë londinezët janë Todd Boehly, pronar i 20 % të klubit të bejsbollit Los Angeles Dodgers, dhe Steve Pagliuca, bashkëpronar i skuadrës së basketbollit, Boston Celtic.



Golden State tregon forcën ndaj Denverit, fitojnë edhe Dallasi dhe Memphisi

DALLAS, 22 PRILL - Golden State u afrohet gjysmëfinaleve "play-off" në Konferencën e Perëndimit pas fitores 118-113 që ka arritur në fushën e Denverit. Një ndeshje ku kapiteni Curry vijon ta nisë lojën nga stoli, por mbetet shënuesi më i mirë, me 27 pikë, po aq sa edhe Poole. Mirë u paraqit edhe Klay Thompson me 26 pikë, ndërkohë që 37 pikët e 18 reboundet e Nikola



Jokiqit mbetën për statistikë. Pas këtij takimi, Warriorsi udhëheq 3-0 serinë. Në Perëndim edhe dy takimet e tjera të luajtura. Memphisi përmbys disavantazhin e sfidës së parë, duke fituar me rezultat 104-95 jashtë fushe dhe udhëheq 2-1 me ndeshje. Bane me 26 pikë ishte më i miri,

ndërkohë që 41 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. 2-1 udhëheq me ndeshje edhe Dallasi, që e mundi me rezultat 126-118 Utah Jazzin. Shtatë lojtarë të Dallasisit realizuan mbi 10 pikë (Bronsoni 21 pikë më i miri), ndërsa për Jazzin nuk mjaftuan 32 pikët e Mitchellit.

KONFERENCA E LINDJES - ÇEREKFINALE "play-off"

Miami - Atlanta	(2-0)
Philadelphia - Toronto	(3-0)
Milwaukee - Chicago	(1-1)
Boston - Brooklyn	(2-0)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇEREKFINALE "play-off"

Phoenix - New Orleans	(1-1)
Dallas - Utah Jazz	126-118 (2-1)
Golden State - Denver	118-113 (3-0)
Memphis - Minnesota	104-95 (2-1)

Salah: Një ditë mund të largohem nga Liverpooli

LIVERPOOL, 22 PRILL - Liverpooli po zhvillon një sezon fantastik. Është vetëm dy pikë larg Manchester Cityt në Premierë Ligë, në garë me kohë të plotë për titullin në Angli, në të njëjtën kohë është në finalen e FA Cup dhe në gjysmëfinalen e Ligës së Kampioneve. Jashtë fushe jo gjithçka është kaq e "kopsitur", në shtëpinë e "The Reds" qëndron e hapur "çështja" Salah. Sulmuesi ka një kontratë deri në vitin 2023, por ende nuk ka pranuar rinovimin. Për këtë temë ka folur vetë sulmuesi. "Nuk e di ende. Kam akoma një vit kontratë. Mendoj se tifozët e dinë se çfarë dua, por nuk është vetëm çështje parash. Nuk e di se çfarë të them, nuk e di saktësisht", u shpreh Salah. "Ky klub do të thotë shumë për mua. Jam argëtuar shumë këtu, në të njëjtën kohë kam dhënë gjithçka për Liverpoolin. Këtë besoj e kanë parë të gjithë. Kam përjetuar emocione të mëdha. Kam fituar shumë trofe, ekipor dhe individual. Liverpooli për mua është si një familje. Herët apo vonë, një ditë mund dhe të



largohem, do të jetë shumë trishtuese, pasi tifozët këtu 2 apo 3 herë këndojnë këngën time", ka shtuar Salah.

Xavi: Ishte fitore jetike për të ardhmen e skuadrës

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka thënë se fitorja ndaj Real Sociedadit (0-1) ishte shumë e rëndësishme. "Jam i kënaqur me tri pikët.

Është një fitore jetike për të ardhmen e skuadrës dhe klubit. Nuk jam i kënaqur me lojën. Ne vuajtëm në pjesën e dytë. Duhet të jemi të sinqertë

dhe vetëkritikë. Nuk kemi luajtur mirë dhe duhet të përmirësohemi", ka thënë Xavi. Real Sociedadit u shkaktoi

shumë probleme blaugranëve, me Xavin që pretendoi se skuadra e tij vuante më shumë se në çdo ndeshje tjetër që kur mori drejtimin. "Është ndeshja

në të cilën ne kemi vuajtur më së shumti, së bashku me atë kundër Villarrealit. Ne vumë re lodhjen tonë", ka deklaruar Xavi.

SHKURT

Reja: Napoli duhet ta transferojë Asllanin

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Edi Reja, ka folur për të përditshmen sportive italiane "La Gazzetta dello Sport", për mesfushorin kuqezi të Empolit, Kristjan Asllani. Reja ka deklaruar se Asllani tani është i destinuar për një klub të madh dhe se do t'ia këshillonte De Laurentis që ta transferonte te Napoli. "Asllani është një lojtar shumë interesant. Për mua ai është i destinuar që të shkojë te një klub i madh. Nëse De Laurentis më pyet, unë do t'i këshilloja menjëherë për të Napoli. Më ka bërë përshtypje personaliteti i tij dhe në muajin mars bëri debutimin e tij me Kombëtaren A të Shqipërisë ndaj një përfaqësuese të madhe si Spanja edhe pse është 20 vjeç. Përshtypja është e mrekullueshme sepse ai di të qëndrojë në fushë në mënyrë inteligjente dhe ka dy këmbë të shkëlqyera", ka thënë Reja.

Alves: Reali me fat që Barcelona u zgjuam vonë

Mbrojtësi Dani Alves ka thënë se Real Madridi është me fat që Barcelona e gjeti formën e saj shumë vonë, duke pretenduar se blaugranët janë mjaft të talentuar për ta sfiduar titullin e La Ligës. "[Real Madridi] është me fat që u zgjuam aq vonë sa nuk mundëm të luftonim për titullin. Tani duhet të mendojmë për një objektivi tjetër", ka thënë Alves.

Përfundon sezoni për Pogban

Mesfushori Paul Pogba e ka humbur sezonin me Manchester Unitedin pas një lëndimi të marrë në ndeshjen ndaj Liverpoolit. Lajmi është dhënë nga "B/R Sport". Mungesa e Pogbas do të ndihet shumë, veçanërisht në ndeshjen ndaj Arsenalit në kuadër të Premierë Ligës. Ndeshja ndaj Liverpoolit mund të jetë e fundit për francezin me "Djajtë e Kuqë", i cili pritet të largohet nga "Old Trafford" në fund të sezonit. Kontrata e 28-vjeçarit skadon pikërisht në verën e këtij viti, me palët që nuk janë të interesuara për vazhdim të bashkëpunimit. Futbollisti u transferua te Manchester Unitedi nga Juventus për shumën e 105 milionë eurove në vitin 2016. Gjatë kësaj kohe ai fitoi trofe si FA Cup dhe Evropa Ligën.

Vritet kampioni i shumëfishtë ukrainas në luftë me Rusinë

Lufta në Ukrainë ia mori jetën një tjetër sportisti. Ivan Oleksandrovich, kampioni ndërkombëtar në gjuajtjen me hark, fitues i medaljeve të shumta dhe anëtar i ekipit kombëtar të Ukrainës, vdiq gjatë luftës me ushtrinë ruse. Më 20 prill, gjatë luftimeve të ashpra në rrethin Borislav të rajonit Kherson, vdiq Ivan Oleksandrovich, mjeshër i sporteve të Ukrainës, kampion ndërkombëtar në gjuajtje me hark, kampion i shumëfishtë, fitues i kampionateve evropiane dhe fitues i medaljeve të shumta. Ai jetonte në Marganec. "Lavdi e përgjeshme për ju! Ne do të kujtojmë. Ne nuk do të falim", thuhet në faqen e internetit të Shoqatës së Qitësve të Ukrainës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Toska” SH.P.K. me pronar Arben Toska Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Toska” D.O.O. Arben Toska Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Toska” L.L.C. Arben Toska Gjilan, has come to the decision to quit its business: nr. Unik Identifikues 811187857 nrb: 71339297 nr. fis: 601713911 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo

**Njoftim për tatimpagues****Pajisu me PEF/SF dhe lësho Kuponë Fiskal!**

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor aty ku nuk kërkohet të lëshohet faturë tatimore, janë të obliguar që të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale (PEF), gjegjësisht Sistem Fiskal dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen te tatimpaguesit, të cilët:

- Kërkohe të fiskalizohen, por nuk janë të pajisur me PEF/SF;
- Janë të pajisur me PEF/SF, por nuk lëshojnë Kuponë Fiskal;
- Lëshojnë kuponë jo-fiskal dhe përdorin pajisje jo-fiskale.



Disa nga veprimtaritë, si: tregti, prodhim, shërbim, shëndetësi, hoteleri, arsim, transport, artistike-zbavitëse, etj. nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të pajisen me PEF/SF dhe të lëshojnë Kuponë Fiskal.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë kërkesave ligjore, në të kundërtën do të aplikohen ndëshkimet administrative, ashtu siç janë përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Krijoj mirëqenie të përgjithshme, merr Kuponin Fiskal!

Administrata Tatimore e Kosovës

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “REB BULLI”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Lumnije Mula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

▶ Ardijan Gjini nga Doblibare, Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. “Vëllezërit Lleshi” nga klasa e –I- deri në të –VIII-tën.

▶ Haki Ramadani shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën SHMLT “11 Marsi” Prizren.

▶ Burim Selmani shpall të pavlefshme diplomën SHMLT “11 Marsi” Prizren.

▶ Leonor Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU “Ekrem Rexha ‘Drini’” Lubizhdë

▶ Milazim Sallauka shpall të pavlefshme diplomën SHMLT “11 Marsi” Prizren.

▶ Rami Braha shpall të pavlefshme diplomën SHMLT “11 Marsi” Prizren.

▶ Argjent Neziri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, dhjetë , njëmbëdhjetë dymbëdhjetë dhe diplomën e SH.M.T. “Nexhmedin Nixha”.

▶ Endrit Shabani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjet njëmbëdhjetë dymbëdhjetë të SH.M.L. Teknike “Nexhmedin Nixha”.

▶ Agim F. Jaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike “Nexhmedin Nixha”.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen “Mati 1” Rr. “Muharrem Fejza”, banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen “Mati 1” rruga “Muharrem Fejza” Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen “Mati 1” përball “Super Vivës”, me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

